

## Deklaratë për shtyp: Vëzhgimi i ri kombëtar zbulon se dhuna ndaj grave ndodh gjerësisht në Shqipëri

Tiranë, 24 maj 2019. *Një në dy* (52.9%) gra shqiptare kanë përjetuar dhunë gjatë jetës së tyre. Kjo është një prej gjetjeve të Vrojtimin Kombëtar me bazë Popullatën “Dhuna ndaj grave” i lançuar sot.

Pas vrojtimeve kombëtare të parë dhe të dytë (2007, 2013) që trajtuan vetëm dhunën në familje, vrojtimi kombëtar i vitit 2018 grumbullon për herë të parë të dhëna për natyrën dhe shtrirjen e formave të tjera të dhunës: **dhuna gjatë marrëdhënies dashurore, dhuna nga jopartneri, ngacmimi seksual dhe përndjekja** dhe paraqet edhe gjetje për **normat sociale** që lidhen me dhunën ndaj grave.

**65.8%** e grave të intervistuar kishin përjetuar dhunë në marrëdhëniet dashurore gjatë jetës së tyre, **47%** kishin përjetuar dhunë në familje nga partneri intim; **1 në 5** gra kishin përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale dhe **18.2%** e grave kishin përjetuar dhunë nga jopartneri.

Vrojtimi zbulon se 18.1% e grave kishin përjetuar ngacmim seksual gjatë jetës së tyre dhe 12.6% e grave kishin përjetuar përndjekje.

Vrojtimi sjell të dhëna për pranimin e dhunës ndaj grave mes burrave dhe grave në Shqipëri. Gjetjet zbuluan se **1 në 2** gra besojnë se dhuna midis burrit dhe gruas është një çështje private; dhe 46.5% e grave besojnë se një grua duhet të durojë njëfarë dhune për të mbajtur familjen të bashkuar; 26.1% e grave besojnë se gruaja duhet të ketë turp, apo të ndihet keq të flasë me dikë nëse është përdhunuar. Të dhënat e vrojtimin shërbejnë për të monitoruar përparimin e bërë për treguesit e Objektivave 5 dhe 16 të Zhvillimit të Qëndrueshëm që lidhen me dhunën ndaj grave dhe vajzave.

Të gjitha gratë e intervistuar thanë se dhuna në familje, dhuna seksuale dhe ngacmimi dhe përndjekja janë probleme të mëdha për shoqërinë shqiptare. 83 % e grave besojnë se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesat/familjet e tyre dhe 81.9% e grave besojnë se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga sulmet seksuale dhe përdhunimi.

Në fjalën e saj Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Delina Ibrahimaj, tha se : “Kjo dukuri, është një nga shkeljet më të mëdha të të drejtave të njeriut në shoqërinë ku jetojmë sot, duke përfshirë thuajse të gjithë grupmoshat dhe komunitetet, si dhe një nga çështjet më kritike të cilat kërkojnë menjëherë marrjen e masave dhe zgjidhje të problematikave. Ndaj, shpresoj që ky takim të shërbejë si një shtysë për të nxitur dhe lëvizur mekanizmat shtetërorë, organizatat e huaja, shoqërinë civile dhe të gjithë aktorët e tjerë për ta luftuar këtë dukuri me të gjitha format dhe mënyrat. Më tej ajo shtoi se: “Të drejtat e grave janë thelbësore për arritjen e një zhvillimi të



qëndrueshëm, paqes dhe sigurisë kombëtare dhe është roli ynë si statisticienë dhe si gra që të japim kontribut në ndryshimet pozitive të lidhura me zhvillimin e shoqërive ku jetojmë”.

Brian Williams, Koordinatori Rezident i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri tha: “Duke marrë në konsideratë këto gjetje të vrojtimit, bëhet i nevojshëm forcimi i politikave, planeve të veprimit, përfshirë legjislacionin, që mbrojnë gratë dhe vajzat nga të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë edhe format e reja ose format e pranuar së fundi të dhunës ndaj grave, të tilla si ngacmimi seksual dhe përndjekja, si dhe format e DhNG-së që nuk raportohen nga gratë në polici dhe në institucionet e drejtësisë dhe fuqizimi i organizatave që mbështesin viktimat”.

Vrojtimi u krye në 12 prefektura në Shqipëri. Kampioni përbëhej prej 3.443 familje ku u intervistuan gra të moshës 18-74 vjeç. 42.4% e grave të intervistuar kishin arsim të mesëm të ulët (8-9 vjet), 27.8% e grave të intervistuar kishin arsim të mesëm të lartë, dhe 19.7% kishin arsim të lartë; vetëm 7.7% e grave kishin vetëm arsim fillor ose më pak.

Vrojtimi u krye nga INSTAT-i në bashkëpunim me UNDP dhe UN Women dhe me mbështetjen financiare të qeverisë së Australisë dhe UN Women në kuadër të projektit rajonal për statistikat gjinore dhe për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm “Gratë vlejné” dhe të qeverisë së Suedisë.